FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 75 — 10 maj — 2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 321, datë 19.4.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Kryeministrinë	3231
Vendim i KM nr. 363, datë 24.4.2013	Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Autotraktorëve, uzina Fonder - Mek, Shkozë, Tiranë	3231
Vendim i KM nr. 364, datë 24.4.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës	3238
Vendim i KM nr. 365, datë 24.4.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 414, datë 11.7.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Lezhë, të qarkut të Lezhës", të ndryshuar, dhe nr. 515, datë 18.7.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar	3239
Vendim i KM nr. 366, datë 24.4.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa ambienteve, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare te Ministria e Financave, për Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit	3243
Vendim i KM nr. 367, datë 18.4.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë"	3247

Vendim i KM nr. 368, datë 30.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar.....	3247
Vendim i KM nr. 370, datë 30.1.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Golem të qarkut të Tiranës	3248
Vendim i KM nr. 371, datë 2.5.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores model të planifikimit”	3249
Vendim i KM nr. 372, datë 3.5.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 23 qershor 2013	3250
Vendim i KZHR nr. 8, datë 25.4.2013	Për financimin e projekteve në zbatim të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve	3251
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Skënderi.....	3265
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Nevruz Harizaj	3265
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shaqir Ndreu	3265
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Kujtim Belegu	3266

VENDIM
Nr. 321, datë 19.4.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri "Shpenzime korrente", t'i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, për shërbimet e kërkimit në fushën ligjore dhe të lobizmit, të cilat do të shërbejnë për forcimin e marrëdhënieve midis institucioneve të Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe atyre të vendeve të tjera, si dhe identifikimin e tërheqjen e financimeve nga agjenci të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe agjenci të tjera ndërkombëtare dhe të investimeve në fusha me interes.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 363, datë 24.4.2013

PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË AUTOTRAKTORËVE, UZINA FONDER - MEK, SHKOZË, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 14 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objektet e ish-Kombinatit të Autotraktorëve, Uzina Fonder - Mek, Shkozë, Tiranë, sipas listës së objekteve, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimin në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këto objekte, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të bëjë kalimin në pronësi të këtyre objekteve për banorët e pastrehë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Çdo akt i dalë përpara miratimit të këtij vendimi shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E OBJEKTEVE QË NDODHEN BRENDA TERRITORIT TË FONDER – MEK.

Nr/R	Emërtimi i objektit	Sip.tr. M²	Sip.nd. M²	Sip.tot. M²	Shënime
1	Objekti nr. 2,2/3		8545.50	8545.50	Reparti Mekanik
2	Objekti nr. 3, 4, 4/1		850.00	850.00	Kaldaja dhe Oxhaku
3	Objekti nr. 5, 5/1		771.60	771.60	Reparti rulo – tambure
4	Objekti nr. 7, 7/1		561.00	561.00	Godinë e paisjeve jashtë standartit
5	Objekti nr. 8, 8/1,2,3		3039.10	3039.10	8 – Reparti i Gizës Sferoidale; 8/1 – Godinë e zyrave – 2kt; 8/2 – Objekt; 8/3 – Fondria
6	Objekti nr. 9, 9/1, 2,3,4,5,6		5306.80	5306.80	9. – Fonderia e Gizës; 9/1 – Rep. remont të fonderisë së gizës; 9/2 – Rep. i plastmasit; 9/4 – Ish kabinë elektrike; 9/5 – Godin. e zyrave; 9/6 – Objekt.
7	Objekti nr. 14		340.70	340.70	Ish magazinë
8	Objekti nr. 15		308.00	308.00	Objekt
9	Objekti nr. 16		250.00	250.00	Objekt
10	Objekti nr. 17		125.00	125.00	Ish depo helmesh
11	Objekti nr. 19		216.00	216.00	Kompresorë
12	Objekti nr. 24		414.00	414.00	Mag. e pasijeve elektrike
13	Objekti nr. 25		31.00	31.00	God. e pompës së solarit
14	Objekti nr. 2,2/3		411.10	411.10	Reparte plastmasi
15	Objekti nr. 27/1,2,3,4		882.90	882.90	Mag. e modeleve të drurit (Zdrukthari)
16	Objekti nr. 29		380.60	380.60	Mag. e kimikateve të plastmasit.
				Sip.= 22437.3 M²	

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA NR.3 E PUNETOREVE TE QYTETIT

LISTA E PLOTE E FAMILJEVE QE BANOJNE NE GODINAT ISH-KOMBINATIT TE AUTOTRAKTOREVE NE UZINEN E FONDER-MEK

1.	LEKË SHAN GJONI	
2.	ROLAND LEKË GJONI	
3.	DAKE ZEF LLESHI	
4.	GJOKË PREND MULAJ	
5.	GJON PREND GJURA	
6.	GJIN LEKË PJETRI	
7.	NUE MARASH VUKAJ	
8.	KUME MARK ZMALI	
9.	HASAN HYSEN TËRSHALLA	
10.	DILBER SEFEDIN LLAÇI	
11.	JAKË PRENG PËRLALA	
12.	MITËR MARTIN ULNDEAJ	
13.	ISA TOSKA	
14.	VLADIMIR PJETËR KOLA	
15.	ALEKSANDËR PJETËR KOLA	
16.	GJERGJ PAL NIKA	
17.	NIKOLIN GJERGJ NIKA	
18.	NUSH KOL ZEFI	
19.	XHUFE NDREC ZEFI	
20.	FRAN KOL ZEFI	
21.	KUJTIM SOKOL MALBUÇAJ	
22.	ZEF GEGË HYSENI	
23.	SOKOL PAL STRALAJ	
24.	ALFRED PJETËR RAMAJ	
25.	ILIR ADEM SELIU	
26.	ISA MAN SYLAJ	
27.	LAVDIM NEVRUZ BRAHA	
28.	RUSHE GEGA	
29.	TONIN MARTIN MULAJ	
30.	ARTAN JONUZ XHANGOLLI	
31.	AGRON MUHARREM CAKAJ	
32.	RUZHDI MALIQ GJANA	
33.	ERVINA VASIL XHAMO	

34.	MEHMET BAJRAM DISHA	
35.	DAUT IBISH MATOSHI	
36.	MEHMET ALI ZENELI	
37.	FESTIM TEFIK HOXHALLI	
38.	ERION FESTIM HOXHALLI	
39.	ALEKS ZEF KOLA	
40.	MARK ZEF KOLA	
41.	ZEF MARK KOLA	
42.	MAN REXHEP HAKAJ	
43.	AVDI ARIF HAXHIAJ	
44.	ERMAL PËRPARIM MALAJ	
45.	ZAJ KOL ZEFI	
46.	MIRE MARK ZEFI	
47.	XHEMAL TAHIR HALILI	
48.	AGIM ADEM HATI	
49.	SHEFQET ADEM HATI	
50.	LULZIM TAHIR FILOLLI	
51.	FIQIRI TAHIR FILOLLI	
52.	LUTFI TAHIR FILOLLI	
53.	FRAN PAL KEÇANI	
54.	ARMIR FRAN KEÇANI	
55.	HETEM KAMBER KOXHAJ	
56.	ALTIN MEHMET DËRMYSHI	
57.	ELEZ YMER META	
58.	NDREC NDUE MARKGGJOKAJ	
59.	GJON NDUE MARKGJOKAJ	
60.	GEG PRENG LENGISI	
61.	SANDËR PJETËR DODA	
62.	BASHKIM SHKOZA	
63.	SHPËTIM RASIM GJANA	
64.	JAKOV PJETËR DODA	
65.	DAVIDE PRENG ÇOKU	
66.	GJIN NDUE KADELI	
67.	ANTON DED VUKA	
68.	LUMTURIJE LIMAN HOXHA	
69.	RAMAZANE TEL KULLOLLI	
70.	HABILIAN HATEM KULLOLLI	
71.	DRIM BRAHIM MULLAI	
72.	SHERIF DEMIR QYRA	
73.	HALIM BAJRAM XHAFERRI	
74.	FAIK BAJRAM XHAFERRI	
75.	LUTFI SHAQIR HOXHA	
76.	ASTRIT SHAQIR HOXHA	
77.	PALI PETRIT DOKOLLI	
78.	FIDAN DULE MILLOSHI	

79.	BEXHET MELEQ KULLOLLI	
80.	JORGO SHEFIT ZENELI	
81.	DURIM KUJTIM GUZI	
82.	FATMIR SHEFIT ZENELI	
83.	AGRON SHEFIT ZENELI	
84.	XHEVDET DAUT LLAPUSHI	
85.	FERDINANT ESTREF DEDJA	
86.	SELAJDIN DURO YMERI	
87.	VLADIMIR SELAJDIN YMERI	
88.	ISMET SELMAN BENGU	
89.	RAMIZ HAMZA MEMAGA	
90.	LIMAN ARTI GOXHAJ	
91.	SYL TAHIR GERAJ	
92.	AUREL DOD GJINAJ	
93.	ROLAND DOD GJINAJ	
94.	ZEF FRROK TOMA	
95.	BASHKIM REXHEP HASA	
96.	BEQIR XHEMAL KURTI	
97.	GEZIM XHEMAL KURTI	
98.	BESNIK ISMAIL SULA	
99.	FADIL OSMAN BUDINI	
100.	BASIR MAKSUT SALA	
101.	MARK GJEK KACORRI	
102.	BARDH FRROK KACORRI	
103.	VASIL SHAQIR XHAKOLA	
104.	NDERIM BAJRAM KRYPI	
105.	SHABAN HAXHI REXHA	
106.	BARDHOK NIKOLL KOKA	
107.	ZEQIR ZENEL OSMANAJ	
108.	JEMIN OSMAN RRUMBULLAKU	
109.	ALTIN QAZIM TUFA	
110.	NAFIE BEQIR GJYRIQI	
111.	MAXHUN HASAN DEMIRI	
112.	GJON GJET KOLA	
113.	TONIN GJET KOLA	
114.	OLTION NEKI YMERI	
115.	LIM AQIF KOCI	
116.	FLORIAN AQIF KOCI	
117.	SABRI	
118.	MARK NDUE GJOKA	
119.	SELMAN BAJRAM DAJTI	
120.	ELTON BAJRAM MANCAKU	
121.	LEJLA ABDYL ZAJMI	
122.	AQIF GANI KOCI	
123.	ERDIT NEKI YMERI	

124.	LUTFIE RIZA KOCI	
125.	ANESTI ASIM KOXHAJ	
126.	BAFTI NDUE KOLPRECI	
127.	MARK PREL GJEKAJ	
128.	BILBIL SHABAN KOCAJ	
129.	ILIR GJONI	
130.	MARK LAZI	
131.	DED MARK KUKAJ	
132.	ZEF MARK KUKAJ	
133.	DRITAN NIKOLL PEPKOLAJ	
134.	FRANG MARK CAMAJ	
135.	JAK PJETER NDOU	
136.	MARK PAL GJONI	
137.	ASLLAN MEHMETI	
138.	GJERGJ ASLLAN MEHMETI	
139.	BEQIR BRAHIM GJEDIA	
140.	FLORINDA ISUF METAJ	
141.	NDOK NIK MALAJ	
142.	SHAN GRIME PERBIBAJ	
143.	ZEF GJON MRISHAJ	
144.	KOL NDUE PRECAJ	
145.	FRAN ZEF PREBIBAJ	
146.	CESK FRAN PERBIBAJ	
147.	TONE VATAJ	
148.	TON UKSHIN NDOU	
149.	FILE GJERGJ NDOU	
150.	PREK PALI	
151.	LEK MARK PERBIBAJ	
152.	FLORIAN PASHK CUNI	
153.	DRITAN GJOK ARAPI	
154.	ASTRIT LLESH GJINAJ	
155.	VASIL JOVAN ZHAMO	
156.	CELNIK OSMAN VELIU	
157.	DRITAN TEFIK FUSHA	
158.	RAZIJE FUSHA	
159.	AVNI RUSTEM SINANI	
160.	KISMET ELEZ META	
161.	ALBERT SADRI DOÇI	
162.	YLLI BESIM ALMADHI	
163.	ALEKS PJETER PAPLEKA	
164.	AHMET IBISH ALIAJ	
165.	ILJAZ OSMAN IMERAJ	
166.	SABRIJE RUSTAJ	
167.	HALIT AHMET HASANPAPAJ	
168.	KAMBER FEJZULLAH DOCI	

169.	MENTOR HALIL HYSENAJ	
170.	MYFIT KAMBER KOÇAJ	
171.	ELIDON BALI ABAZI	
172.	NDOC DED KOLA	
173.	GURTALI SALI KUME	
174.	LEONARD MUHAMET PREJA	
175.	FATMIR RESHKA	
176.	ASIM SEJDI DEMIRI	
177.	REXHEP RUSTEM SINANI	
178.	BILBIL RUSTEM SINANI	
179.	FATBARDH DURO YMERI	
180.	SHEFIT DANA HYSO	
181.	BARDH TEFIK FUSHA	
182.	MARKO MEHMET DYRMISHI	
183.	ANTON ZEF LEGISI	
184.	FLORI FERIT DOKU	
185.	VAIT KOXHA KOCI	
186.	DOD ZEF LEGISI	
187.	PJETRALIN PREND LIKA	
188.	ANGJELIN GJET SUTA	
189.	ARTAN FERIK HASMUÇA	
190.	REALD FERIK HASMUÇA	
191.	AVNI FERIK HASMUÇA	
192.	GJON NDUE COCAJ	
193.	MIRA MARK DEDA	
194.	PRENG GJET LUCI	
195.	NDUE GJOK PERSHQETAJ	
196.	FITORE MUHARREM ISUFAJ	
197.	FADIL IBISH ALIAJ	
198.	FATMIR FADIL ALIAJ	
199.	ALI IBRAHIM GJEDIAJ	
200.	DEMIR SEHIT AHMATI	
201.	ISLAM BEQIR HASMUÇA	
202.	RUZHDIJE PETREH AHMATI	
203.	ARIAN SHERIF MIRAKA	
204.	BASHKIM ISUF TARE	
205.	SHKËLQIM ADEM HETI	
206.	DILAVER HASHIM LEKA	
207.	GËZIM HASHIM LEKA	
208.	ARDIAN HASHIM LEKA	
209.	VIKTOR THIMJO KOSTA	
210.	BESMIR RAMIZ GJURIQI	
211.	FAHRI RAMIZ GJURIQI	
212.	HAZRET AGIM HAXHIAJ	
213.	FATMIR KALEM KARAJI	

214	KALEM HAXHI KARAJI	
215	FERDINAND NDREC MARKAJ	
216	ILIR NDREC MARKAJ	
217	NDREC GJON MARKAJ	
218	SIMON GJIN GJINAJ	
219	TARA GJON GJINAJ	
220	NDUE PJETËR DUSHI	

VENDIM
Nr. 364, datë 24.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FUSHË-ÇIDHËN TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr. 1237, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fushë-Çidhën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fushë-Çidhën — Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
50	Prona që përdoren për realizimin e funksionit në fushën e administratës	Në pronësi
51-56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën arsimit	Në pronësi
57-62	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit	Në pronësi
63-70	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
71-94	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e infrastrukturës rrugore	Në pronësi

96-99,101,102,104,105,106, 108,109,110,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësi-ushqimit, toka produkteve	Në përdorim Nuk transferohen sipërfaqet e trajtuara me VKM, nr. 868, datë 18.6.2008
100,103,107,112,134-136	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësi-ushqimit, toka joprodhuese, ujitje, kullim. Mbrojtje nga përmbytjet	Në pronësi
115-118	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 365, datë 24.4.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NR. 414, DATË 11.7.2007 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS", TË NDRYSHUAR, DHE NR. 515, DATË 18.7.2003 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 8 e 8/a, shkronja "b" të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë bashkisë së Lezhës dhe heqjen nga lista e pronave të paluajtshme, bashkëlidhur vendimit nr. 414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të pjesës së truallit prej 442.8 (katërqind e dyzet e dy pikë tetë) m^2 të pasurisë 9/49, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8631, të qytetit të Lezhës, e cila përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

2. Transferimin në pronësi të bashkisë së Lezhës të mjediseve të Shtëpisë së Ushtarakëve, Lezhë, prona me nr. 981, pjesa e mbetur në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, përjashtuar 3 (tri) mjediset, me sipërfaqe të përgjithshme 42.1 (dyzet e dy pikë një) m^2 të katit të parë, sipas planimetrisë dhe formularit që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat do t'i shërbejnë kësaj bashkie për kryerjen e funksioneve administrative e të shërbimeve.

3. Bashkisë së Lezhës i ndalohet t'ia ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Mjediset e Shtëpisë së Ushtarakëve, Lezhë, të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e pronave të paluajtshme, bashkëlidhur vendimit nr. 414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

MINISTRIA E MBROJTJES
LEZHË

Nr.	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Numri i pronës	Lloji i pronës	Emërtimi i pronës, adresa	Sipërfaqja totale (m^2)	Nga sipërfaqja totale sa ndërtime në m^2	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				Shtëpia e Ushtarakëve Lezhë	1730 m^2	843 m^2	Për trajnimin e ushtarakëve	MM SHQU Tiranë	Shtëpia e Ushtarakëve Lezhë	-
				Lezhë	887	-				
				Hotel, bar, restorant	843	843				

PLANIMETRIA E OBJEKTIT SHTËPIA E USHTARAKËVE LEZHË



PLANIMETRIA E OBJEKTIT SHTËPIA E USHTARAKËVE LEZHË



VENDIM
Nr. 366, datë 24.4.2013

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA AMBIENTEVE, NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE TE MINISTRIA E FINANCAVE, PËR NJËSINË E MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare te Ministria e Financave për Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit të disa ambienteve, sipas planimetrisë dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Dorëzimi i ambienteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi të bëhet pas përfundimit nga AMF-ja të transferimit të pajisjeve në një afat 45-ditor.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni Qendrorë: Ministria e Financave

Fusha e përdorimit të pronës: Administratë

Nr.	A			B						T t
	Zona Kadastrale dhe indeksi i hartës	Numëri i Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës (adresa)	Sipërfaqja e pronës: Sipërfaqja Totale (m2)	Sipërfaqja e pronës: Nga kjo: Ndërtesë (m2)	Funksioni që të cilin përdoret Prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni që e përdor Pronën	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
1		3876	Ndërtesë	Rruga "Perlat Rexhepi", pallati i ri 10 katësh, Tiranë, kati i parë (i banueshëm) i përbërë nga 6 (gjashtë) Zyra, 4 (katër) ballkone dhe 2 (dy) banjoTiranë	211.00	211.00	Zyra pune	Ministria e Financave	Njësisa e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit	


PLANIMETRIA E KATIT TE PARE (SHK. 1:100)
KUOTA + 3.50
(MBI DYQANE)


MIRATOHET
PER K.R.T. E BASHKISE SE TIRAN
KRYETARI
SALI KELMENDI
PLAN VENDOSJA E GODINES NE PRONEN
E FAMILJES SELFOLLARI
SHK 1=500
RRUGA "A. FRASHERI,
RR. "VASO PASHA,
RRUGA "PERLAT REXHEPI,
5 KT
6 KT
9 KT
8 KT
2 KT
10 KT
3 KT

VENDIM
Nr. 367, datë 18.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 678, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË TEKSTILEVE TË PAMBUKTA, NË TIRANË, TË NDËRMARRJES MEKANIKE-TEKSTILI, TIRANË DHE TË ISH-SHKOLLËS SË PARTISË, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Enti Kombëtar i Banesave të bëjë kalimin në pronësi, pa kundërshpërblim, të këtyre objekteve, për personat, të cilët i kanë aktualisht në përdorim.".

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave, Njësia Bashkiake nr. 11, Tiranë, dhe ish-Kombinati i Tekstileve të Pambukta, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 368, datë 30.4.2013

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. l19/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nënndarjen e tretë të pikës 6 të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas emërtesës "Drejtor i kabinetit të Avokatit të Popullit" shtohet emërtesa "Koordinator Kombëtar për urdhrat profesionalë, pranë Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga momenti i emërimit të nëpunësit në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 370, datë 30.1.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GOLEM TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Golem të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 110 (njëqind e dhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 773 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Golem për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Golem — Lidhja nr. 1

15	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
16-30, 64, 65, 66	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
54-63	Varrezat publike	Në pronësi
68 -663, 665- 672	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
676-677	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

696-699, 701-702, 704, 705, 707, 708, 710, 712-715, 717-720, 721, 723-725,727, 729, 731	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorin Në zbatim të VKM-së nr. 567, datë 5.9.2007, ZMMT-ja e komunës Golem dhe DAMT-ja e qarkut Tiranë, ka vënë në dispozicion të AKKP-së sipërfaqen e tokës prej 232.74 ha. Në këtë sipërfaqe përfshihet dhe baza eksperimentale e shkollës së mesme Golem, gjithsej 10.62 ha, e cila në listën e inventarit ka numrin 696 (bashkëlidhur lista e pasurive që i kanë kaluar AKKP-së). Këto sipërfaqe nuk transferohen.
700, 703, 706, 709, 711, 716, 722, 726,728, 733, 736, 738, 741, 742, 745, 747, 749, 752, 755, 761, 764, 767, 770	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 371, datë 2.5.2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 88 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në shtojcën 1 "Rregullorja model e planifikimit", bashkëlidhur vendimit nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 2, shtohen shkronjat "dh" dhe "e" me këtë përmbajtje:

"dh) përcaktimin e përdorimit të lejuar të tokës deri në hartimin e instrumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit;

e) përcaktimin e parametrave zhvillimorë të lejuar deri në hartimin e instrumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit.".

2. Pas shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 4, shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) zhvillimin e strukturave me funksion administrativ në arsim, bujqësi, industri ushqimore, ekonomi ndihmëse bujqësore, shëndetësi, infrastrukturë, transport, e strukturave ushtarake, institucioneve fetare, shërbimeve tregtare, magazinave tregtare, shërbimeve sociale.".

3. Në pikat 2, 3, 4 dhe 6 të nenit 7, fjalët "… kategori ekzistuese të përdorimit të tokës …" zëvendësohen me "… kategori ekzistuese dhe të lejuara të përdorimit të tokës …".

4. Në pikën 1 të nenit 8, fjalët "… kategori ekzistuese të përdorimit të tokës …" zëvendësohen me "… kategori ekzistuese dhe të lejuara të përdorimit të tokës …".

5. Në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 9, fjalia "Intensiteti i ndërtimit të nënnjësisë strukturore" zëvendësohet me "Intensiteti i ndërtimit të nënnjësisë strukturore për kategorinë e tokës A. Banim".

6. Kudo në tekstin e rregullores, termi "Rregullore kombëtare e planifikimit" zëvendësohet me "Rregullore uniforme e instrumenteve të planifikimit".

II. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në nenet 5 e 12 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 372, datë 3.5.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MË 23 QERSHOR 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të vitit 2013, t'i shtohet një fond prej 719 000 000 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, nga i cili 679 000 000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë milionë) lekë, për shpenzime operative, për projektet SEN dhe SEV, dhe 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për shpenzime për investime.

